



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar			
12.01.2022			
Nj. Org	Numër	Sh. J	Vlera
12-052/01-1710			



Komuna e Drenasit
Municipality of Drenas

Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Drenasit për vitin 2021

Gjatë vitit 2021, ne, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi mbajtur gjashtë mbledhje, raportet e të cilave janë dorëzuar më kohë tek personat përgjegjës. Takimin e parë e kemi mbajtur vetëm në anëtarët e këtij Komiteti. Në këtë takim kemi diskutuar për fushëveprimtarisë që mbulon komiteti ynë, kemi hartuar planin e veprimit për vitin 2021 si dhe kemi ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për secilin anëtarë të komitetit.

Takimin e dytë e kemi mbajtur me organizatat që veprojnë në Komunën e Drenasit e që fushëveprimtari e kanë rininë. Pikat e rendit të ditës ishin:

- Problemet, që e preokupojnë të rinjët e Drenasit
- Subvencionimi i projekteve rinore në Drenas
- Të ndryshme

Në këtë mbledhje u diskutua ekskluzivisht vetëm për rininë. Po ashtu në këtë mbledhje ishin të ftuar edhe përfaqësuesit e OJQ-ve, të cilët prezantuan pikëpamjet e tyre për problemet, që preokupojnë të rinjtë e Drenasit.

Takimin e tretë e kemi mbajtur së bashku me Komitetin Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara me këto pikat e rendit të ditës:

1. Arsimi dhe Aktivitete Edukative në Drenas
2. Aktivitetet Kulturore
3. Aktivitetet Sportive
4. Infrastruktura për PAK në përgjithësi në komunën e Drenasit e në veçanti në shkolla

5. Përfshirja e PAK në aktivitetet e OJQ-ve aplikuese në shpalljet publike për grante dhe subvencione në kuadër të drejtorive përkatëse në komunën e Drenasit (Inkurajimi i OJQ-ve nga komitetet kompetente)

6. Bashkëpunimi me Organizatat që veprojnë në fushën e shërbimeve për PAK, dhe shënimi i datave të vecanta për këta persona

7. Nxitja e fushatave vetëdijësuese në shkolla dhe shoqëri, mbi paragjykimim dhe diskriminimin që ju bëhet këtyre nxënësve lidhur me aftësinë e kufizuar që kanë.

Takimin e katër e kemi mbajtur me përfaqësuesit e ansambleve që funksionojnë në komunën tonë. Me qëllim që të njihemi nga afër me angazhimet dhe sfidat e ansambleve, të cilat funksionojnë në Komunën e Drenasit kemi zhvilluar takime të ndara me udhëheqësit e këtyre ansambleve. Takimin e parë e kemi mbajtur me udhëheqësit e ansambllit “Shotë Galica”. Ky ansambël është më i vjetri në Komunën e Drenasit, i themeluar në vitet e 60-ta dhe ka një historik të bujshëm me aktivitete kuturore, pjesëmarrje në festivale të ndryshme në mbarë trojet shqiptare dhe më gjërë, ku janë vlerësuar me shumë çmime nga juritë profesionale.

Ansambli “Shotë Galica” aktualisht ka mbi 60 anëtarë. Ansambli ka grupin e këngëtarëve, instrumentistëve dhe vallëtarëve. Në kuadër të këtij ansambli funksionojnë dy grupe:

- a) Grupi i të rinjëve, i cili përfshinë rreth 30 anëtarë si dhe
- b) Grupi elitar, i cili po ashtu përfshinë rreth 30 anëtarë

Sipas udhëheqësve të këtij ansambli, sfida kryesore për vazhdimin e veprimtarisë së tyre është mungesa e lokalit, ku ata mund të ushtrojnë dhe ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Udhëheqësit e ansambllit “Shotë Galica” kanë identifikuar disa lokacione që ka Komuna e Drenasit, e të cilat do të mund t’i shfrytëzojë ky ansambël. Njëri ndër lokacionet është një sallë në ndërtesën e vjetër të Komunës së Drenasit. Po ashtu ky ansambël gjatë veprimtarisë së tyre ka marrë shumë çmime dhe mirënjohje dhe kërkesë e udhëheqësve të ansambllit është që Komuna e Drenasit ta gjejë një vend të përshtatshëm dhe t’i ekspozojë këto çmime për publikun e gjerë. Gjithashtu udhëheqësit e ansambllit “Shotë Galica” kërkuar që Komuna e Drenasit t’i ndjekë praktikën e komunave përreth dhe të shikoj mundësinë e pagesës së udhëheqësve të këtij ansambli, pasi që ata veprimtarinë e tyre e ushtrojnë krejtësisht në baza vullnetare.

Takimin e dytë e kemi mbajtur me ansambllin “Shqiptet e Drenicës” në Sallën e Kulturës në Drenas, ku kemi parë nga afër aktivitetet që zhvillon ky ansambël. Në këtë ansambël ishin afërsisht 60 anëtarë, të rinj e të reja nga mosha 9 vjeç e deri 20. Ne kemi parë nga afër përkushtimin e udhëheqësisë së këtij ansambli për të aktivizuar dhe për të mbajtur në formë të rinjët e angazhuar, duke përgatitur program artistik të larmishëm me valle të ndryshme nga të gjitha trevat shqiptare. Disiplina profesionale, puna në grup, rrespekti i ndërsjellë, edukimi

grupor dhe fryma grupore e krijuar në këtë trup ishte për çdo lavdatë dhe meriton përkrahje pakusht nga ana e Drejtorisë së Kulturës në Drenas.

Takimin e radhës e kemi pasur me sportistë dhe udhëheqës të klubeve sportive që funksionojnë në Komunën e Drenasit. Në këtë takime kemi diskutuar këto pika të rendit të ditës:

1. Funksionimi i klubeve sportive në komunën e Drenasit
2. Organizimi i aktiviteteve sportive gjatë periudhë së pandemisë COVID 19
3. Idetë për zhvillimin e politikave sportive në Drenas (Mundësitë e aktivizimit të klubeve sportive në sported olimpike që i mungojnë komunës sonë, si atletikë, gjimnastikë, xhudo, ski, etj.) etj.

Takimin e pestë e kemi mbajtur me drejtorin e DKA-së zt. Muhamet Gjoka, ku kemi diskutuar këto pika të rendit të ditës:

- Përgatitjet që DKA ka bërë për fillimin e vitit shkollor 2021/2022
- Paisja e nxënësve me tekste mësimore
- Lista e pagave
- Pagesa e shujtave të mësimdhënësve
- Të ndryshme

Takimin e fundit e kemi mbajtur me Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit zt. Milaim Hajdari, ku diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Plani vjetor i Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (KKAKRS)
2. Diskutimi i rekomandimeve të nxjerra nga KKAKRS
3. Të ndryshme

Më poshtë janë të listuara rekomandimet tona.

Rekomandimet

Të gjitha rekomandimet kanë dalë pas hulumtimeve që kemi bërë, ne, anëtarët e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe pas takimeve të drejtëpërdrejta me mësimdhënës, drejtor shkollash, prindër, nxënës, student, sportist, udhëheqës të klubeve të ndryshme sportive, udhëheqës të ansambleve, që funksionojnë në komunën tonë, përfaqësues të OJQ-ve, që fushëveprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin, etj.

Rekomandimet për fushën e arsimit

Aktualisht ndodhemi në situatë të pandemisë, kështu që gjatë këtij viti shkollor edhe Komuna e Drenasit është ballafaquar me sfida thuajse të njëjta sikurse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Sidoqoftë për ta përballuar më lehtë këtë periudhë ne rekomandojmë që:

- DKA të vazhdojë t'i furnizojë shkollat me dezinfektues dhe maska, si dhe shkollat t'i respektojnë vendimet dhe këshillat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, me qëllim që t'i mbrojnë nxënësit, mësimitdhënësit dhe gjithë personelin e shkollës nga virusët.
- DKA të vazhdojë t'i pajisë shkollat me teknologji dhe mjete tjera të konkretizimit, sepse ende ka shkolla që kanë mungesë të theksuar të mjeteve të konkretizimit. Për më tepër ende ka shkolla, ku mungojnë edhe hartat, të cilat janë më se të domosdoshme për mbajtjen e mësimit në lëndën e gjeografisë.
- DKA të vazhdojë me ndërtimin e sallave sportive në shkolla, sepse shumë shkolla kanë vështirësi në organizimin e mësimit të lëndës së edukatës fizike gjatë periudhës së dimrit.
- DKA ta trajtojë seriozisht çështjen e nxënësve me nevoja të veçanta. DKA përmes psikologut t'i përkrahë shkollat, që kanë nxënës me nevoja të veçanta. Në shumë raste mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave janë ankuar se përkundër kërkesave të tyre në DKA, shkollat NUK janë vizituar nga psikologu. Madje edhe në rastet kur psikologu e ka vizituar shkollën, ai NUK e ka trajtuar nxënësin drejtpërdrejtë, por vetëm ka këshilluar mësimitdhënësit. Kështu që DKA-ja të shqyrtojë seriozisht trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta drejtpërdrejt nga psikologu i DKA-së ose të punësojë psikologë me bazë në shkollë, për shkak se disa nxënës kanë nevojë për trajtim ditor nga psikologu. Po ashtu DKA-ja përmes ekipës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta të bejë vlerësim objektiv të nxënësve duke marrë në konsideratë edhe raportet e psikiatrit dhe psikologut klinik. Në raste të jashtëzakonshme MOS të insistojë në përfshirjen e këtyre nxënësve në shkolla të rregullta, sepse janë barrë e papërballeshme për shkollën dhe mësimitdhënësit, përfshirë këtu edhe mësimitdhënësit mbështetës.
- DKA duhet të hartojë një plan të detajizuar për sistemimin e mësimitdhënësve ekzistues, sepse viteve të fundit kemi rënie rapide të nxënësve në komunën tonë. Pra, DKA të këtë kujdes me shpalljen e konkurseve për mësimitdhënësit të rinj, së pari t'i plotësohet norma mësimitdhënësve ekzistues apo edhe të shfrytëzohet mundësia e transferimit të mësimitdhënësve nga një shkollë në tjetrën. Gjithnjë duke u bazuar në performancën e mësimitdhënësit. DKA duhet të këtë kujdes me listën e pagave, sepse numri i mësimitdhënësve që janë jashtë listës së pagave është duke u rritur. Ndër arsytet që kanë ndikuar në rritjen e numrit të mësimitdhënësve jashtë listës së pagave ka kontribuar edhe punësimi i asistentëve dhe mësimitdhënësve mbështetës, të cilët janë të domosdoshëm, megjithatë DKA duhet të këtë shumë kujdes të mos e mbingarkojë sistemin me asistentë dhe mësimitdhënësit mbështetës. Arsye tjetër është punësimi i koordinatorëve të cilësisë dhe bibliotekistëve jashtë kriterëve. Në këto raste NUK është respektuar kriteri i numrit të nxënësve në shkollë. Nëse një shkollë ka 250-500 nxënës, asaj shkollë i takojnë pesë orë bibliotekë dhe katër orë për koordinator të cilësisë. Mirëpo ka shkolla me këtë numër të nxënësve, të cilat kanë bibliotekist me dhjetë orë dhe ka shkolla me numër më të vogël se 250 nxënës, e që kanë koordinator të cilësisë me katër orë. Për ta zvogëluar numrin e mësimitdhënësve që janë jashtë listës së pagave, DKA-ja mund t'i angazhojë disa

koordinatorë të cilësisë si mësimdhënës të gjuhës frënge, mëqë këta koordinatorë të cilësisë e kanë këtë kualifikim dhe ka mungesë të mësimdhënësve të gjuhës gjermane. Ndërsa si gjuhë e dytë e huaj mund të mësohet gjuha gjermane apo gjuha frënge. Mandej të mos shpallen konkurse për mësimdhënës të rinj, por të sistemohen bibliotekistët dhe koordinatorët tjerë të cilësisë si mësimdhënës të lëndëve përkatëse.

- DKA të shfrytëzojë përvojat e komunave përreth dhe ta zgjidhë çështjen e pagesave të shujtave dhe udhëtimit të mësimdhënësve, sepse realizimi i këtyre pagesave përmes përmbauesve privat do ta dëmtojë buxhetin e komunës së Drenasit.
- DKA të shqyrtojë mundësinë që të aprovojë kërkesat e shkollave në zonat rurale, të cilat mbajnë mësim me dy ndërrime dhe që nuk ka ndriqim në ato zona, të mbajnë orët mësimore nga 40 minuta.
- DKA të shqyrtojë kriteret për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë dhe mos t'i përfshijë fare studentët e vitit të parë.

Rekomandimet për fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Bazuar në takimet dhe hulumtimet e komunitetit konsultativ në fushën e aktivitetit kulturorë dhe rinorë në komunën e Drenasit, takimet me grupet e interesit si dhe me përfaqësues institucional kemi arritur në konkludim se megjithëse ka një rritje të aktiviteteve kulturore, rinore e sportive për nga numri e gjithashtu kualiteti që ato ofrojnë, ka akoma shumë për të bërë me qëllim që edhe komuna e Drenasit të zërë vendin që e meriton në fushën e pafund të artit, kulturës e aktiviteteve rinore. Marrë parasyshë situatën pandemike është e vështirë të gjetur një zgjidhje që të paktën të mos stopohen aktivitetet, por të mbahen ato që janë të mundshme dhe të realizohen duke u bazuar në mundësitë dhe hapsirën që situata pandemike ka krijuar. Vlerësojmë se rekomandimet tona profesionale janë në shërbim të të mirës së përgjithshme e gjithashtu në të mirë të politikave komunale për zhvillim më të gjërë në fushat e lartëpërmendura.

Më poshtë gjeni të rënditura disa nga rekomandimet të cilat mendojmë që janë më të nevojshme dhe më emergjente në komunën e Drenasit për vitin 2021.

KULTURË:

- Fondet të cilat janë ndarë për kulturën në veçanti, mendojmë që janë minimale e krahasuar me dikasterin si ai i Sportit, kanë një diferencë dhe raport jashtëzakonisht të dalluar mes njëri-tjetrit.
- Të themelohet një OJQ që do të bashkojë të gjithë artistet në fushën e arketimit që do të luajë rolin e trupës të teatrit të qytetit. Megjithëse, teatri është votuar në Asamblenë.
- Rekomandojmë komunën e Drenasit që të shqyrtojë mundësitë për të ndërtuar një sallë multifunksionale për aktivitetet kulturore në të cilën përfshihen teatri, salla koncertale, muzeu, biblioteka e qytetit, kinemaja, salla për prova teatrale e valleve dhe e baletit, sallë provash për orkestër, galeri punë për artistët vizuel të Drenasit, punëtori për skulptorë, piktorët etj.

- Të themelohet ansambli i qytetit i cili mund të jetë në varësi të DKRS-së dhe Ministrisë së Kulturës e cila gjithashtu është e rregulluar me ligjet e Kosovës, e në këtë ansambël mund të përfshihen antarë të të gjitha shoqërive kulturore artistike të cilat tashmë egzistojnë dhe veprojnë në Drenas siç janë: “Shotë Galica”, “Shqiptet e Drenicës”, “Komorani”, etj.
- Të krijohet një hapsirë, muze për ansamblin ndër më të vjetrit jo vetëm në Drenas por edhe në nivel të Kosovës, Sh.K.A “Shotë Galica” e cila në gjithë këto vite ka numër të madhë të çmimeve, mirënjohjeve, materialeve të cilat janë nga festivale kombëtare e ndërkombëtare.
- Të identifikohen ansamblet aktive në komunën e Drenasit dhe në varësi të punës që ato ofrojnë, numrit të anëtarëve që kanë, të rregullohet edhe ndarja e subvencioneve.
- Të rikthehen festivale të rëndësishme dhe historike siç janë “Ditët e Humorit”, “Revista Burimore Folklorike”, sepse kanë një rëndësi në rritjen e interesit për artin e bukur folklorik që e kemi si popull e gjithashtu për të sjellë ansamble të ndryshme nga anë e mbanë trojet shqiptare, ashtu siç kanë ardhë për çdo vit që nga viti 1962 e këtej.
- Të financohen më fuqishëm festivalet aktuale, shumë të rëndësishme siç janë “Drenasi Fest”, “Muaji i Mërgatës” etj.
- Të ndahen në fundvit çmime për artistët aktiv, të cilët dallohen për veprat e tyre, dhe jo vetëm sportistët siç ka nodhur këto vitet e fundit.
- Të shqyrtohet mundësia e paisjes me një skenë të re profesionale.

RINI

Komuna e Drenasit dallohet për një rini të shëndoshë, inteligjente e më shumë potencial. Këtë vit kemi parë se si KVRL e cila suportohet çdo vit nga DKRS-ja, ka realizuar disa projekte mjaft të rëndësishme në Drenas.

- Në ndarjen e Bursave për nxënësit e dalluar që ndahen për çdo vit nga Kryetari i komunës dhe nga DKA-ja, të caktohet kriter pjesëmarrja në aktivitete rinore. Gjithashtu mendojmë se në këtë formë rritet interesimi i të rinjëve që të bëhen pjesë e aktiviteteve rinore, e gjithashtu stimulon të rinjët nëpër shkolla që t’u bashkangjiten projekteve të ndryshme, pse jo në të ardhmen të bëhen ata nismëtar të iniciativave që kanë të bëjnë me rininë.
- Një ndër shqetësimet që është ngritur nga pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes së komitetit konsultativ me komunitetin rinor, ka qenë mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë me shkollat e mesme në Drenas. Ne mendojmë që duhet t’u rekomandohet drejtuesve të shkollave në Drenas që të bashkëpunojnë ngusht me aktivistët dhe aktivitetet rinore sepse është në të mirën e të gjithëve, dhe jo për shkak të mos bashkëpunimit të humbet një projekt shumë më dobi për shkollën siç kishte ndodhur vitin e kaluar ndërmjet OJQ “Qendra Rinore” dhe Shkollës së mesme në Drenas. OJQ-të dhe aktivitetet rinore janë në të mirë të shkollave e gjithashtu mund t’i ndihmojnë ato në realizimin e nevojshëm të seminareve, punëtorive të ndryshme në vetëdijësimin e të

rinjëve për tema të ndryshme sociale, andaj duhet të mirret parasysh të gjenden forma bashkëpunimi në kontinuitet ndërmjet shkollave dhe të rinjëve tanë.

- DKA dhe DKRS së bashku me Kryetarin e komunës të krijojnë një fond të veçantë për inovacion dhe teknologji në të cilën të rinjtë tanë të kenë mundësi të thellohen në atë që është bashkëkohore, teknologjinë, që sot për sot është gati e domosdoshme në pikëpamjen e avansimit dhe koherencës tek të rinjtë.
- Të zhvillohen këto trajnime me qëllim ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve të cilat veprojnë në Drenas që të kërkojnë dhe të mbajnë përgjegjësi për punët që bëjnë.
- Të rinjtë të kenë qasje në objektin e ri i "Qendrës për Të Rinjtë me qëllim që të rinjtë të kenë adresë të saktë për të vazhduar me thellimin e tyre në aktivitete të ndryshme.
- Të organizohen kuize në nivel komunal, kuize inovative në të cilat përfshihet edhe teknologjia dhe këtë ta organizojnë të rinjtë për të rinjtë.
- Të bëhet një tryezë ndërmjet organizatave kulturore dhe atyre rinore në Drenas me qëllim të bashkëpunimit më të thellë ndërmjet tyre,

SPORT

Sporti në Drenas e sidomos futbolla ka arritur shumë suksese dhe na ka bërë krenar në vazhdimësi, por a është e mjaftushme kjo?!... mendojmë që ka hapësirë për t'u përqendruar akoma më shumë edhe në sporte tjera dhe kështu të shfrytëzojmë gjithë talentin që e kemi tek sportistët tanë, e këta të fundit të prezantohen sa më shumë e sa më mirë.

- Të gjindët një formë e bashkëpunimit me biznese për daljene krizës së klubit Feronikli.
- Së fundi është hapur klubi i çiklizmit, gjë shumë pozitive për komunën tonë. Andaj kërkojmë që të mendohet seriozisht që të vendosen stazat e çiklistëve në komunën tonë, kështu mbrojmë edhe mjedisin dhe u japim mundësi qytetarëve që të lëvizin më lirshëm nëpër qytet e gjithashtu krijojmë një frymë europiane në komunën tonë duke anashkaluar sa më shumë të jetë e mudnur makinat. Ky klub, i cili ndodhet në Komoran e i cili është i vetmi i këtij lloji në komunën tonë ka nevojë për mbështetje të veçantë nga DKRS dhe komuna sepse si i tillë është i vetmi në komunën tonë.
- Ndërtimi i sa më shumë fushave sportive sintetike në komunën tonë është shumë i mirëpritur.
- Kur nxënësit e shkollave marrin pjesë në gara komunale me sporte si futboll, volejball etj., të sigurohet transporti i këtyre fëmijëve qoftë nga DKRS, apo nga DKA dhe kjo gjë mos t'u ngarkohet vetëm pedagogëve ose aq me keq nxënësve, sepse fundja ata përfaqësojnë vendin tonë.
- Turniri i mirënjohur i futbollit në Nekovc dhe turnire të tilla që organizohen nga grupe, individë e organizata sportive në vendin tonë duhet të kenë përkrahje më të madhe financiare, çdo aktivitet sportiv në Drenas na shërben ne që të rrisim kapacitetet, si të tilla nganjëherë është më mirë të mos financohen klubet e mëdha, sepse fundja ato financim

kanë, por t'u kushtohet vëmendje këtyre klubeve e organizimeve të vogla me qëllim që edhe këto të bëhen të mëdha një ditë.

- komuna të ndaj një lokacion poligoni për çitje, një ndër sportet më interesante,
- Meqë tashmë ligji për sponzorizim ka hyrë në fuqi, është një lehtësim i madh për çdo sportist ose klub në komunën tonë e gjithashtu është me interes për bizneset bashkëpunuese të cilët duan të financojnë sporte të ndryshme e të cilët nuk janë shumë të informuar se si funksionon ky ligj i veçantë. Andaj ne rekomandojmë që DKRS-ja së bashku me klubet sportive dhe përfaqësuesit e saj të organizojnë një takim konsultativ me bizneset e Drenasit dhe aty të diskutohen mundësitë e mbështetjes e cila besojmë që nuk do të mungonte dhe kështu edhe komuna do të hiqte një barrë të financimit nga vetja.

Në fund, shpresojmë se rekomandimet tona do të trajtohen seriozisht dhe do të merren si të mirëqena dhe dobiprurëse për arsimin, kulturën, fëmijët dhe sportin në Drenas.

Komitetit Knsultative për Arsim, Kulturë, Rinë dhe Sport në Komunën e Drenasit

Gentrit Mulaku – kryetar

Resmije Krasniqi - nënkryetare

Nuhi Nika - anëtar

Zyrafete Morina - anëtare

Robert Nuha - anëtar



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLËGGËC			
G.L.L.G.G.C MUNICIPALITY			
Pranuar	13/01	2021	
Nj. Org	numër	Shifra	Vlera
12-	060-	1898	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit
Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale



RAPORTI VJETOR I KOMITETIT KONSULTATIV PËR MBROJTJE TË AMBIENTIT ZHVILLIM EKONOMIK, SHËNDETESI DHE MIRËQENIE SOCIALE PËR VITIN 2021

DRENAS 2022

Raporti vjetor për vitin 2021

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Dokumenti në fjalëpërban një përmbledhje të mbledhjeve të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Mjedisit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (më tuje KKZHEMMSHMS) të cilat janë të dokumentuara me fotografi dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, si dhe temat e diskutimit.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Përmbajtja

Përmbledhje.....3

Takimet Formale

Takimi I Parë.....5

Takimi I Dytë8

Takimi I Tretë.....11

Takimi I Katërt.....12

Takimi I Pestë.....14

Takimi I Gjashtë.....16

Rezultatet dhe Përfundimi.....18

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

PËRMBLEDHJE

Aktualisht është viti i tretë që Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Mjedisit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale vepron në kuadër të Komunës së Drenasit.

Është viti i dytë I pandemisë, në të cilin vështirësitë po na përcjellin në kohë të vazhdueshme duke reflektuar edhe në komitetin tonë.

Kemi pasur gjashtë takime formale dhe takime joformale. Takimet janë thirrur nga kryesuesi e po ashtu edhe nga anëtarët e komitetit. Pjesëmarrës të takimit ishin të gjithë anëtarët e komitetit siç vijon:

1. Fitore Sefiu-Shabani-kryesuese
2. Burim Dvorani-nënkryesues
3. Arbresha Haziri-anëtare
4. Violeta Ipshi-Bujupi-anëtare
5. Basri Gashani-anëtarë

Në takime kemi pasur të ftuar Kryetarin e komunes e po ashtu edhe drejtorë të dikastereve të ndryshme, kemi dhënë rekomandime si gjatë diskutimeve, e po ashtu edhe me shkrim, e të cilat gjithmonë janë marrë parasysh.

Për punën tonë është njoftuar edhe opinion publik për mes faqes që kemi hapur në njërin nga rrjetet sociale nga e cila kemi shqyrtuar edhe disa probleme që qytetarët na kanë njoftuar përmes saj.

Duke besuar se pas çdo vështirësie do vijë edhe lehtësimi duhet edhe më shume të inkurajojmë projekte që për qëllim kanë përmirësimin e mirëqenies sociale për banorët tanë.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit
Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

TAKIMET FORMALE

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Takimi I parë

Mbledhja e parë për vitin 2021 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 27.01.2021. Të ftuar në këtë mbledhje patëm Kryetarin e Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovcin dhe Drejtoreshën për Shërbime Publike dhe Emergjente znj. Lumnije Krapin.Po ashtu nëpërmjet rrjetit social facebook për mbledhjen e komitetit është njoftuar edhe opinionin.

Temat e diskutimit ishin:

1.Procesverbali I datës 27.11.2020,

2.Dëmet e shkaktuara nga vërshimet e fundit në Komunën e Drenasit

3.Raportet e Vlerësimit të dëmeve në infrastrukturë,dëmet e shkaktuara në shtëpi banimi,dëmet në biznese dhe në kultura bujqësore.

Të reshurat atmosferike që filluan me 07.01.2021 e të cilat vazhduan edhe ditëve në vazhdim në komunën e Drenasit shkaktuan vërshime si në tokat bujqësore, shtëpi banimi ,infrastrukturë,e në biznese.

Me ndihmën e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe te Zjarrfikësve është bërë evakuimi I 15 familjeve të cilat kanë qenë në rezik gjatë vërshimeve.Një familje është strehuar nga restorani Nobel I cilli kishte shprehur gatishmërinë që të strehoj të gjitha familjet që është dashur të evakohen.Ndërsa 45 anëtarë të tjerë janë strehuar tek familjarët e tyre.

Me rritjen e nivelit të ujit u shkaktuan shumë dëme në infrastrukturë shpesh edhe duke e bërë të pamundhme qarkullimin e qytetarëve.

Urat më të dëmtuara janë në fshatin Dobroshec në lagjet Ademi, Prenku, Hajdari etj.

Vlera totale e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë nga vërshimet e nxjerrë nga komisioni për vlerësim është 1,705,00.00 €.

Në shtëpi banimi dëmet e të cilave janë verifikuar nga komisioni e që jane rreth 97 sosh vlera e dëmeve arrin në 217,643.20€.Këtu diku rreth 28 shtëpi në fshatin Shtrubullovo, 25 shtëpi në Çikatovë e Re, 21 në Poklek të Ri etj.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021



Fig.1. Takimi me Kryetarin e Komunës z.Lladrovcin dhe Drejtoreshën znj.Krapi

Dëmet e lajmëruara nga qytetarët për kulturat bujqësore nga vërshimet e mëdha nga komisioni për verifikim janë vlerësuar me 6,738.20€ të cilat kryesisht kanë qenë sipërfaqë me grurë dhe gidanë të arrës.

Ndërsa dëmet në biznese kapin shumën prej 479,517€ .Bizneset në fjale gjenden në Qendrën Tregtare-Drenas Komoran,Polluzhë, Poklek të ri, dhe Shtrubullojë.

Nga të gjitha vlerat që u thanë më lart, në total komunës së Drenasit kjo fatkeqësi natyrore I ka shkaktuar dëme në vlerë prej 2,408,898.40€.

Nga Kryetari dhe Drejtoresha morem informatë se Raportet mbi Vlerësimet e Dëmeve janë dorëzuar në afat të caktuar kohorë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Nga ko e fundit presim në kompezim të mjeteve të parapara edhe pse për dëmet e shkaktuara nga vërshimet kjo e fundit I ka ndarë vetëm 1000,000.00 €.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Mjetet e ndara nga Qeveria për Komunitetet kanë si prioritet Ekonomite Familjare dhe Bizneset me kompenzim të 25%.

Fatkeqësitë natyrore nuk mund të ndalohen, mirëpo pasojat e fatkeqësive I bartë vet faktori "Njeri" I cili me vetëdijen e tij tokat bujqësore I shëndrton në vendbanime, in kthen në deponi e shum llojë të degradimeve duke rrezikuar edhe vet jetën e vet. Gjatë ndërtimit të shtëpive apo edhe lokaleve afariste shum nga ata nuk pajisen me leje ndërtimore. Shpresojme që kjo fatkeqësi të mos përseritet duke besuar se kemi marë një mësim të mirë.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

TAKIMI I DYTË

Takimi i dytë për vitin 2021 i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 27.03.2021. Të pranishëm në këtë mbledhje ishim anëtarët e Komitetin në kryesim nga Fitore Sefiu Shabani

Temë e diskutimit ka qenë :

1. Shfrytëzimi I ujit në industri dhe energjetikë
2. , Mungesa e ujit të pijshëm në Komunën e Drenasit
- 3.Vërshimet e hapsirave pas shirave të rrëbeshëm



Fig.2. Anëtarët e Komitetit

Operoret industrial dhe ata energjetik janë shpenzuesit më të mëdhenj të ujit. Në rangun e operatoreve më të mëdhenj të shfrytëzimit te ujit në Kosovë radhiten: **KEK, Feronikeli, dhe Sharrcemi**. Këta operatorë furnizohen me ujë kryesisht nga liqenet akumuluese sipërfaqësore. Një pjesë e operatorëve të vegjël industrial, shfrytëzojnë ujin nga ujësjellësit publik, kurse një numri i vogël i tyre përdorin sistem vetanak të furnizimit me ujë nga pusët

New Co Feronikeli furnizohet me ujë për procesin teknologjike nga Bivolaku (hidrosistemi IbërLepenc), i cili ndodhet 17 km larg nga fabrika. Ky ujë pranohet në basenet e ujit që ndodhen

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

sipër fabrikës. Uji në Feronikël shfrytëzohet si: ujë industrial për nevojat e operatorit dhe një pjesë e vogël e ujit trajtohet për përdorim si ujë i pijshëm. Uji industrial përdoret kryesisht për ftohjen e furrave elektrike, granulimin e skories, prodhimin e avullit dhe për sistemet e pastrimit të gazrave dhe pluhurit të konvertorët dhe furrat elektrike. Pjesa më e madhe e ujit industrial pas ftohjes në kullat ftohëse riqarkullohet, dhe shpenzimi më i madh i ujit është gjatë procesit të avullimit (kullat ftohëse, granulimi i skories).

Sipas të dhënave NeëCo Feronikeli, gjatë vitit 2013 janë shfrytëzuar rreth 1.2 milion m³ ujë, që shënon një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin paraprak. (shih figurën).




Fig.3. Sasia e ujit të shpenzuar ne NeëCo Feronikel, 2009-2013

Në shum vende publike e sidomos të atyreve nëpër fshatra pas një shiu të rrëbeshëm kemi vërshime të hapsirave të cilat hapsira janë rrugë që shfrytëzohen edhe nga këmbësorët.

Në figurat më poshtë janë paraqitur fotografi përballë hyrjes së një shkollën në një fshat.



Fig.4.Hapsira me ujë para hyrjes së shkollës



Fig.5.Hapsira me ujë para hyrjes së shkollës

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Takimi I tretë

Mbledhja e tretë për vitin 2021 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 29.06.2021.

Temat e diskutimit ka qenë :

1. Ndërtimi i qerdhes në Tërstenik
- 2.Ndërtimi i qerdhes në Nekoc, dhe
- 3.Të ndryshme

Në mbledhje u diskutua tema aktuale me focus të veqantë, forcimi i sistemit arsimorë në nivelin parafillorë.

Komuna e Drenasit posedon vetëm një institucion parafillor publik me paralelen e saj të ndarë në Bushat, numër ky shumë i vogël dhe i pamjaftushëm për sistemin e numrit të fëmijëve të grupmohave përkatëse.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Projektet e propozuara nga niveli local për këto problem edhe nuk janë finalizuar, gjë e cila shkakton telashe të mëdha për familjet konkretisht prindërit e fëmijëve të cilët detyrohen të dërgojnë fëmijët e tyre në kopshte private me një kosto dyfish më të latrë.

Shqetësim tjetër jo pak i vogël mbetet transporti I fëmijëve nga fshatrat e komunës së Drenasit pai pothuajse asnjë fshat i kësaj komune nuk ka asnjë kopsht qoftë public apo privat.

Prindërit e fëmijëve që jetojnë nëpër fshatra detyrohen që fëmijët e tyre ti sjellin në qendrën e qytetit.

Komiteti jone nga kjo mbledhje doli me rekomandimin për Komunën e Drenasit sin ë vijim:

- Të shpejtohen punimet për ndërtimin e kopsheve qe kanë filluar,
- Të shikohet mundësia për ndërtimin e kopshteve tjera nëpër fshatra qe janë me popullsi relativisht të madhe si p.sh. Tersteniku
- Të përmisohen kushtet në kopshtet aktuale.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Takimi I katërt

Mbledhja e katërt për vitin 2021 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Mjedisit, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS), u mbajt më 17.08.2021. Të ftuar në këtë mbledhje patëm Drejtoreshën për Drejtorinë e Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit znj. Flutra Avdiu. Po ashtu nëpërmjet rrjetit social facebook për mbledhjen e komitetit është njoftuar edhe opinioni.

Temat e diskutimit në këtë takim ndër të tjerat ishin:

1. Procesverbali i datës 29.06.2021,
2. Legalizimi i ndërtimeve pa leje
3. Legalizimi i ndërtimeve në komistacion



Fig.6. Anëtarët e komitetit me të ftuarit

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Në Komunën e Drenasit janë identifikuar gjithsej 13,904 objekte pa leje shifër kjo e dhënë në vitin 2017. Procesi I legalizimit të ndërtimeve të ndërtuara ka filluar qysh më heret mirëpo si process ka pas shumë mangësi dhe ka qenë thuajse I dështuar

Komuna e Drenasit përkatësisht Drejtoria per Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit si dhe ne mbeshtetje te USAID kane filluar projektin per legalizimin e ndertimevev pa leje me 3 gusht te ketij viti I cili project do te perfundon deri ne shtator.

Usaid ka ndihmuar Komunen ne infoirmimin e qytetarëve duke ndihmuar në shtypjen e pllakareve, fletushkave, billboard-eve si dhe me njesine mobile përkatësisht furgonin e ndriqar me LED në të cilin është treguar procedura e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme.

Gjithashtu ne kete takim u informuam se objekete që janë ndërtuar para vitit 2004 nuk do të paguajnë taksen prej 1 euro për metër katror për ndërtimet e kategorisë I siq janë shtëpi banimi, vila, depo, stalla, pishina të hapura garazha etj.

Po ashtu në pytyjën tonë drejtuar drejtoreshës se a janë të mjaftushëm inspektorët që mbikshyrin punën e ndërtimeve, morëm përgjigje që numri I tyre është I pakët

Interesim patë edhe në zonat ku para pak kohe patë vërshim nga shirat e ku në ato zona ka ndertime të cilat janë ndërtuar pa leje e kryesisht janë shtëpi banimi se a do të legalizohen, ku përgjigje morëm se janë ne listë të pritjes dhe se në nivelin qëndror do të mirret një vendim për ta.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Takimi I pestë

Mbledhja e peste për vitin 2021 e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 22.09.2021.

Të pranishëm në mbledhje ishin të gjithë anëtarët e komitetit si: Fitore Sefiu Shabani-kryesuese, Burim Dvorani-zevendës kryesues, Violeta Ipshi Bujupi Arbreshë Haziri dhe Basri Gashani antarë.



Fig.7.Antarët e Komitetit

Temat e diskutimit në këtë takim ndër të tjerat ishin:

1. Procesverbali I dates 17.08.2021
2. Mundësia e klasifikimit të mbeturinave në vendet rurale dmth plastiken nga mbeturinat tjera
- 3.Fillimin e nje sondazhi në faqen e Komitetit në facebook se sa qytetarët do të përkrahin këtë iniciativë
4. Të tjera.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Secila shtëpi banimi në baza ditore krijon për afro 3-4kg mbeturina nga të cilat gati pothuaj gjysma e kësaj peshe mundet me qenë plastike. Duke e parë që plastika si një lëndë e rrëzikshme dhe e pa degradueshme dhe me vëllim shumë më të madh se lëndët tjera e kemi pa të arsyshme që këtë problem të adresojmë te kompetetët relevant dhe tek qytetarët e komunës tonë.

Një formë se kishim mundur të bëjmë këtë ndarje kish me qenë si në foton më poshtë:



Fig.8. Një formë e grubullimit të hedhurinave plastike

Organet kompetente për shërbimet publike kishin me qenë mirë që të sigurojnë mbledhjen e plastikës hedhurinë duke siguruar që të shkojnë në vendin e duhur e pse jo edhe në riciklim.

Siq u tha edhe më lart këtë iniciativë të klasifikimit të mbeturinave do e iniciojmë edhe në faqën e komitetit në facebook në formë sondazhi me ndjekësit e faqes përkatësisht qytetarët e komunës së Drenasit. Nga të dhënat që do të mbledhim do të krijojmë një rekomandim për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Takimi I gjashë

Takimi i gjashtë për vitin 2021 të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Mjedisit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 11.10.2021.

Të pranishëm në mbledhje ishin të gjithë anëtarët e komitetit si:Fitore Sefiu Shabani-kryesuese, Burim Dvorani-zevendës kryesues, Violeta Ipshi Bujupi Arbreshë Haziri dhe Basri Gashani antarë ndërsa te ftuar kishim Milaim Hajdari Drejtor I Inspektionit dhe shef I Drejtorisë së Inspektionit Halim Vrellaku

Temat e diskutimit në këtë takim ndër të tjerat ishin:

1. Procesverbali I dates 11.10.2021
- 2.Vështirsitë që ka seksioni I Inspektoratit
- 3.Inspektimet e tregut,ambientit, sanitarisë, komunikacionit dhe ndërtimit
4. Sa luan rol qytetari në ndihmën e kryerjes së inspektimeve?

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021




Fig.9. Antarët e Komitetit dhe të ftuarit

Sektori i inspekcionit është një sector që lirisht mund të themi është më sfiduesi .Roli kyq i inspektorit është që të siguroj zbatueshmërit e ligjeve, rregulloreve, vendimeve të lëshuara nga organet kompetetne nga ana qytetarëve. Drejtoria e Inspekcionit raportimet e saja I kryen në suaza ditore, javore, mujore e vjetore.

Në vitin 2020 drejtoria e inspekcionit ka hartuar 323 procese, 1500 aktvendime, 13 pëlqime, 25 kërkesa dhe 62 gjoba në vlerë prej 5550€.

Vetëm gjatë kohës së pandemisë drejtoria e inspekcionit ka dhënë 3500 aktvendime të karantinimit për familjet e të sëmurët me COVID 19.

Në pyetjen tonë se sa here në vit vizitohen bizneset për inspektim sanitar sipas z.Hajdarit inspektimi ndonëse me vështëri është bërë disa herë në vit varësisht sipas kërkesës. Numri shum I vogël I inspektorëve 3 në atë të tregut, 1 ne ate te ambientit, 1 ne sanitari, 1 ne atë të komunikacionit dhe 2 në atë të ndërtimit e ka bërë mjaft të vështirë funksionimin e mirëfillt të Drejtorisë së Inspekcionit.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Problem kyq në drejtorinë e Inspektionit është edhe se 3500 shtëpive në Komunën e Drenasit janë të ndërtuara në tokat bujqësore e që për to pritet të vendoset në instancat më të larta të shtetit. Poashtu edhe marrja e lejeve të ndërtimit paraqet problem në vete për shkak të vonesave të marrjes së lejeve për ndërtim. Vlenë të theksohet se edhe parcelat e trashëguara nga paraardhësit e të cilat trashëgëmi nuk janë të dokumentuara paraqet një vështirësi në vete.

Rezultatet dhe përfundimi

Si duket vitet pandemike do të na përcjellin me vite të tëra, prandaj duhet të adaptohemi me një gjendje të tillë.

Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale trajtuam problemet nga më të ndryshmet me të ftuarit që kishim present në disa nga takimet tona.

Besojmë që takimet tona kanë qenë të frytshme dhe konstruktive duke bërë rekomandime të qastit si dhe duke vënë në pah problemet dhe duke qasur problemeve në një kerd tjetër vështrimi, atë të qytetarit.

Vlenë të theksohet se thirrjeve tona për takime u janë përgjigjur pozitivisht të gjithë të ftuarit duke u nisur nga kryetari e duke vazhduar me drejtorët e drejtorive të digastereve të ndryshme të Komunës së Drenasit.

Raporti Vjetor i Komitetit Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit Zhvillim Ekonomik, Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021

Ngjarjet Kryesoreqë e karakterizuan këtë vit ishin Vërshimet qe ndodhën ne Janar te viti që e lam pas, procesi i legalizimit të ndertimeve pa leje, mundësia e ndarjes së mbeturinave në vendet rurale, vështirësitë që ka drejtorja e inspektionit gjatë inspektimeve si dhe gjatë zbatimeve të urdhëresave të lëshuara nga drejtorja e etj.

Besojmë që qdo vit i rradhës që do të vie do të na hapen dyert e mundësive të rej të zhvillimit të ekonomisë e që është kusht i mirëqenie sociale.





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit,
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



12 Nr. 0806/1-1898 dt 13/01 2021

Mbledhjet e Komitetit për KZHEMASHMS, sipas temave të shqyrtuara dh rekomandimeve të dhëna për

Komunën e Drenasit.

Nr.	Temat e shqyrtuara gjatë mbledhjes	Data e mbajtjes së mbledhjes	Rekomandimet për Kuvend.
1	1. Procesverbali I datës 27.11.2020, 2. Dëmet e shkaktuara nga vërshimet e fundit në Komunën e Drenasit 3. Raportet e Vlerësimit të dëmeve në infrastrukturë, dëmet e shkatuara në shtëpi banimi, dëmet në biznese dhe në kultura bujqësore.	27.01.20212	Rekomandim për kuvend nuk pati
2	1. Shfrytëzimi I ujit në industri dhe energjetikë 2. Mungesa e ujit të pijshëm në Komunën e Drenasit 3. Vërshimet e hapsirave pas shirave të rrëbeshëm	27.03.2021	Rekomandim për kuvend nuk pati
3	1. Ndërtimi I qerdhës në Tërstenik	29.06.2021	

	2.Ndërtimi I qerdhes në Nekoc, dhe 3.Të ndryshme		
4	1.Processverbali I datës 29.06.2021, 2.Legalizimi I ndërtimeve pa leje 3.Legalizimi I ndërtimeve ne komistacion	17.08.2021	
5	1. Procesverbali I dates 17.08.2021 2.Mundesia e klasifikimit të mbëturrinave në vendet rurale dmth plastiken nga mbeturinat tjera 3.Fillimin e nje sondazhi në fagen e Komitetit në facebook se sa qytetarët do të përkrahin këtë iniciativë	22.09.2021	
6	1. Procesverbali I dates 11.10.2021 2.Vështrisitë që ka seksioni I Inspektoratit 3.Inspektimet e tregut,ambientit, sanitarisë, komunikacioni dhe ndërtimit 4. Sa luan rol qytetari në ndihmën e kryerjes së inspektimeve?	11.10.2021	Të ofrojnë trajnime për tregun e punës duke bashkëpunuar me bizneset qe operojnë në Komunën e Drenasit



Kryesuesë e komitetit
Fitore Selma Shabani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore



Nr. 052-1571, dt. 12 01 2022

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2021

Janar - Dhjetor, 2021

Hyrje:

- Anëtarët e përzgjedhur të Komitetit Konsultativ për Barazi gjinore në Komunën e Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2021**, kanë organizuar dhe mbajtur mbledhjet sa i përket këtij komiteti.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, **KKBGJ** ka mbajtur disa takime. Ku prej tyre **(6) gjashtë** gjithsej kanë qene mbledhje te rregullta në të cilat përpos diskutimeve në fund te secilit takim ka rezultuar një rekomandim drejtuar institucioneve përkatëse dhe komunës ne Drenas(Gllogoc).

Në secilin takim janë shqyrtuar pika te veçanta dhe rendi i ditës ka qene specifik për secilin takim të mbajtur. Secili takim është shoqëruar me proces verbal dhe raportimin adekuat, pra janë dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar-dhjetor 2021

Janar, 2021

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me **datën 28.01.2022**, ku janë shqyrtuar **(3)** tre pika të diskutimit dhe me këtë rend të ditës. Pas mbledhjes është përgatit raporti për Kuvend.

1. Profesionet e sigurisë, pse këto profesione njihen tradicionalisht si profesione të meshkujve.
2. Përkrahja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të grave.
3. Të ndryshme.

Dukë pasur parasysh numrin e ulët të grave në policinë e Republikës së Kosovës u zhvillua diskutim rreth asaj se pse është numri kaq i ulët i aplikimeve dhe pranimeve në këtë profesion. Ndoshta ndikon edhe mungesa e informatave rreth detyrave se çka përfshinë ky profesion po ashtu kombinuar me obligimet e përditshme të grave në vendin tonë shpesh herë kjo mbetet edhe një temë e padiskutuar.

Ne si komitet vlerësojmë që kjo dukuri deri më tani tregon një pabarazi gjinore, kjo tregohet edhe duke u bazuar tek statistikat : Gratë në Policinë e Kosovës

12.53 % të oficerëve të policisë janë gra, ose 919 nga 7,331 e policëve oficerë .

14.75% e stafit total të Policisë së Kosovës janë gra.

Afërsisht 10% e atyre që shërbejnë në Policinë e Kosovës mbajnë grada të larta ushtarake (një gjeneral, një kolonel, një komandant brigade dhe një kryetar operacionesh)

ne mendojmë se do të kishte qene mire të promovohen profesionet e këtilla tek gjinia më e butë po ashtu bazuar në ligjin në të cilin është themeluar Policia e Kosovës - Ligjin nr. 03/l-035, vërejmë që: Numri i grave me grada të larta ushtarake në PK është 12.5%.

Këto fushata do të ndikonin në:

Ngritja e vetëdijes dhe adresimi i çështjeve në interes për gratë në kuadër të shoqërisë;
Promovimi dhe ndihma në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit ;
Përkrahja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të grave.

Po ashtu bashkëpunimi me institucionet shtetërore ku do të eksitonte mundësia për kryerjen e punëve praktike në lidhje me këto profesione.

LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS 212 Neni 16

Praktikantët

1. Punëdhënësi mund të lidhë Kontratë Punë me praktikantin.
2. I punësuar në cilësinë e praktikantit i cili ka lidhur kontratë pune me punëdhënësin, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit e tjerë.
3. Punëdhënësi i cili pranon praktikant në ndërmarrjen e tij, është i detyruar që të ofrojë mbrojtje dhe siguri në punë duke u bazuar në Ligji Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.

4. Puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj

Prandaj ne rekomandojmë:

Realizimi i fushatave në Komunën tonë që promovojnë profesionet të cilat lidhen me sigurinë. Të cilat tradicionalisht njihen si profesione të meshkujve. Përkrahja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të grave. Ngritja e vetëdijes dhe adresimi i çështjeve në interes për gratë në kuadër të shoqërisë.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Agjencisë së Punësimit, Gratë për gratë

Mars, 2021

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 29.03.2020, ku janë shqyrtuar (3) tri pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi e KKBGJ.

1. Vendi i punës në institucionet publike dhe private, ngacmimet ndaj punëtorëve.
2. Vetëbesimi dhe performanca në vendin e punës;
3. Të ndryshme.

Të punuarit në institucione publike apo private, vetëbesimi është diçka që padyshim ka rënësi dhe ndikon në performancën e secilit. Por jo gjithëherë hasim punëtorë me vetëbesim të lartë dhe kjo si pasojë e ngacmimeve të natyrave të ndryshme të cilat bëhen në vende të ndryshme të punës.

Jo rrallëherë performanca dhe vetëbesimi i punëtorëve lidhen ngushte me sigurinë në punë. Raportet e bëra nga organizata të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut tregojnë qartë se ngacmimet në vendin e punës ndikojnë në uljen e performancës së personave që janë viktimë e ngacmimeve apo diskriminimeve të natyrave të ndryshme, ngacmime këto të cilat mund të rrjedhin si pasojë e pabarazisë gjinore, statusit financiar etj.

Dëgjojmë raste së punëtorët sidomos të bizneseve private janë të volvuar pa dashje në ngacmime të natyrave të ndryshme, ku kërcënohen, keqtrajtohen, shfrytëzohen, u jepen orë shtesë të punës pa pagese, ngarkohen me punë shtesë pa pasur marrëveshje paraprake, u mohohet e drejta e pushimit javor, e vjetor, ju vonohet paga, u mohohet e drejta e pagesës së trustit pensional, ndoshta ka edhe raste të abuzimit seksual të punëtorëve, etj. Për shumë arsye është e nevojshme që të kemi rregullore të qarta të punës dhe ne rekomandojmë që: **Të obligohen të gjitha institucionet publike dhe private si dhe bizneset që të vënë rregullore të qarta lidhur me format kundër ngacmimit të punëtorëve në vendin e punës. Gjithashtu, në rregullore të jepen adresime të sakta lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen që ofron ligji në raste të ngacmimeve të çfarëdo natyre.**

Dukë u bazuar në ligjin e punës :**LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS 212 tek Neni 5**, nen ky i cili përfshin:
Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.
2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.
3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.
4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kriteret dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.
5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit

Qershor, 2021

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 18.06.2021, ku janë shqyrtuar (3) tri pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerr një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Zgjedhja e kryesuesit dhe zv. Kryesuesit të ri të KKBGJ-së pas dorëheqjes së kryesueses Halide Morina.
2. Krijimi i një strehëze emergjence për viktimat e dhunës familjare në komunën e Drenasit.
3. Të ndryshme.

Në pikën e parë të këtij takimi u diskutua për zgjedhjen e kryesuesit dhe zv.kryesuesit të ri të KKBGJ-së. U propozua që kryesuesi i ri të jetë z. Arton Hasani, ndërsa zv. Kryesuesja të jetë Elira Tafilaj-Nebih. Propozimi u miratua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët.

Për pikën e dytë u diskutua për krijimi i një strehëze emergjence për viktimat e dhunës familjare në komunën e Drenasit. Në komunën e Drenasit mungon një strehëz emergjence e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të dhunës në familje që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të mbrojtjes.

Ne KKBGJ-ja kërkojmë krijimin e një strehëze emergjence për viktimat e dhunës familjare në komunën e Drenasit.

Duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm shoqëror që ndikojnë në rritjen e pakënaqësisë dhe pesimizmit në shoqërinë tonë edhe dhuna në familje është një dukuri që po rritet çdo ditë. Të dhënat e fundit të raportimeve të rasteve të dhunës në familje tregojnë që koha e pandemisë Covid-19 ka ndikuar në rritjen e rasteve të

dhunës. Ne si Komitet Konsultativ për Barazi Gjinore e shohim jo vetëm si të nevojshme, por të domosdoshëm krijimin e një strehëze emergjence për personat që janë viktime të dhunës në familje. Kjo strehëz duhet të ofrojë siguri dhe mbrojtje të menjëhershme të viktimave të dhunës deri në gjetjen e një zgjidhje tjetër me qëllim të evidentimit të përkeqësimit të gjendjes në të cilën ndodhet viktime. Kjo shtëpi rehabilituese do të merret me trajtimin psikofizik të viktimave, përveç strehimit dhe rehabilitimit të tyre. Ka shumë raste të dhunës që nuk raportohen pasi që nuk ndjejnë siguri se çfarë do të ndodhë më tutje. Krijimi i ndjenjës së sigurisë është një nga të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, komuna jonë duhet të ofrojë mundësi praktike të reagimit të menjëhershëm të mekanizmave mbrojtës që ofron shteti.

Bazuar në ligjin për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës LIGJI Nr. 05/L -020- Neni 4.2

“Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t’i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar.”

Rekomandimi nga ky takim është se: **Në Komunën e Drenasit mungon një strehëz emergjence e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të referuara që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të mbrojtjes.**

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

Gusht, 2021

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 02.08.2021, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerr një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Takim me drejtoreshën e KRS-së në Drenas.
2. Të ndryshme.

Ne takimi e katër KKBGJ-ja ka pasur takim me Drejtoreshën për Kulture Rini dhe Sport Shqipe Zogu, ku jemi interesuar, se sa klube sportive kane përfaqësim gjinor të anëtareve të tyre, ku u tha se shumica e klubeve sportive në komunën e Drenasit përfaqësohen nga të dy gjinitë, por ka disa klube sportive që përfaqësohen nga meshkujt ose femrat, pra nuk ka përfshirje të të dy gjinive.

Gjatë takimit u diskutua edhe për mungesën e infrastrukturës për zhvillimin e disa aktiviteteve sportive të jashtme si p.sh.: ecja, vrapimi, çiklizmi, etj.

Pas këtij takimi KKBGJ-ja jepi rekomandim që **të behët promovimi i klubeve sportive**

Duke marrë parasysh që shumë të reja dhe të rinjë të Drenasit kanë talente të fushave të ndryshme sportive, atëherë promovimi i klubeve sportive do të ishte i domosdoshëm, ku rinia jonë mund të anëtarësohen në klubet sportive të cilët mund ta shfaqin dhe zhvillojnë talentin e tyre. Ky promovim do të jetë një adresim i mirë për rinin tonë, të cilët do të njoftohen në mënyrë të drejtpërdrejte me klubet sportive dhe mundësit që ofrojnë ato klube

Është kënaqësi kur i sheh të rinjtë e Drenasit duke korrur suksese në sporte të ndryshme, prandaj ky promovim do të jetë një mundësi e artë për sportdashësit, që të anëtarësohen në klubet sportive ku ata mendojnë që kanë talent.

Preferohet që promovimi të behët në një ambient ku e frekuentojnë rinia jonë, dhe promovimi të jetë disa ditorë.

Në këtë promovim të klubeve sportive, duhet t'u jepet trajtim i barabartë të të dy gjinive, pra trajtimi i barabartë pa kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë dhe promovimin e barazisë gjinore

Bazuar në ligjin për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës LIGJI Nr. 05/L -020- Neni 5 pika 1.2 dhe pika 1.6.

1.2. "miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për barazi gjinore"

1.6. "sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit."

Bazuar në ligjin për Sport, LIGJI NR. 2003/24- Neni 2.

Ky rekomandim i është dërguar: Drejtorisë së KRS-së në Drenas.

Tetor, 2021

Mbledhja e peste e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 04.10.2021, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Organizimi i një fushate vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të mesme me qëllim të parandalimit të dhunës në familje.

2. Të ndryshme.

Rekomandimi nga ky takim është: **Organizimi i një fushate vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të mesme me qëllim të parandalimit të dhunës në familje.**

Qëllimi i këtij rekomandimi është që nxënësit të dine të identifikojnë format dhe mënyrat e dhunës në familje. Gjithashtu t'u prezantohen familje model të bashkëjetesës pa dhunë, me tolerance dhe mirëkuptim. Nxënësit gjithashtu duhet të njoftohen se dhuna në familje nuk është një akt normal, por një krim dhe duhet të denoncohet në organet e rendit.

Qëllimi i kësaj fushate vetëdijësuese është edukimi i të rinjeve në shkolla në mënyrë të atillë që brezat e ardhshëm të dine se çfarë janë marrëdhëniet e shëndoshmë familjare, janë të informuar që dhuna në familje është krim dhe është e papranueshme. Këta të rinjë do të jenë të përgatitur për një familje model të bashkëjetesës.

Bazuar në LIGJI Nr. 03/L-182 - LIGJ PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

Neni 1, pika 1 dhe Neni 27

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Drejtorisë Komunale të Arsimit

Nëntor, 2021

Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 01.11.2021, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Zbatimi i ndalimit, qasjes dhe blerjen e produkteve të duhanit për të miturit
Të ndryshme.

Rekomandimi nga ky takim është: **Zbatimi i ndalimit, qasjes dhe blerjen e produkteve të duhanit për të miturit.**

KKBGJ-ja diskutoj për zbatimin e LIGJIT PËR KONTROLLIN E DUHANIT, e ne veçanti për zbatimin e ndalimit të qasjes dhe blerjes së produkteve të duhanit nga të miturit.

Na ndodhe që të shohim fëmijë të mitur (të të dy gjinive) të cilët konsumojnë duhan neper rrugë dhe restorante të ndryshme, dhe jemi plotësisht të bindur se këta fëmijë të mitur furnizohen vet nga shitësit e duhanit, dhe gjithashtu jemi të bindur se nuk hynë ndonjë i rritur për t'u blere duhan, por furnizohen nga shitësit e duhanit, ku këtu kemi shkelje të drejtpërdrejt të Ligjit Për Kontrollin e Duhanit.

Në kërkojmë nga Inspekcioni Komunal që të merret me organizimin e fushatave vetëdijësuese neper shitësit e produkteve të duhanit, e pastaj nëse nuk zbatohet ky ligj të merren masa ligjore ndaj shkelësve të këtij ligji.

Kjo nisme të behët me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe masat parandaluese kundër pirjes së duhanit, veprimet të cilat kanë për qëllim përparimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, si dhe ngritjen e cilësisë të jetës së qytetarëve.

Bazuar në **LIGJI Nr. 04/L-156 PËR KONTROLLIN E DUHANIT**

Neni 1, pika 2.6

Neni 10, pika 1,2,3 dhe 4.

Ky rekomandim i është dërguar: Kryetarit të komunës z.Ramiz Lladrovci. Drejtoria e inspekcionit

Kryesues i KKBGJ

Arton Hasani





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Gllgoc)

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 412/03-2685 dt. 18.01.2022,

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.031/L-040 , nenit 72 pika 72.1 nën (h) të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, Rregullorës nr. 12-400-16587 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba dhe kërkesës se Shoqatës se Transportit Publik të udhëtarve me Autobus “ Drenasi”, me dt.18.01.2022, nr.13-070-2569, Kryetari komunës bjenë këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërrbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Gllgoc, për operim.

I

Me këtë propozim Vendim, kërkohet lirim nga pagesa e peronizimit për kompanit e transportit publik të udhëtarve me autobus për linjat urbano-periferike dhe ndërrbane që shfrytzojnë stacionin e autobusve në Gllgoc për operim.

II

Lirimi nga pagesa e peronizimit, është në aftatin kohor prej 6 muajsh, nga miratimi i këtij Propozim –Vendimi, me mundësi vazhdimi , varësisht prej gjendjes se krijuar Pandemike nga COVID-19.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës se Shoqatës se Transportit Publik të udhëtarve me Autobus që operojn në linjat Urbano-periferike dhe Ndërrurbane në komunën e Glogocit, me dt.18.01.2022, nr.13-070-2569, Kryetari komunës me qëllim të lehtësimit të kryerjes se Shërbimeve për kompanit e Transportit Publik të Udhëtarve, si dhe për shkak të zvoglimit të numrit të udhëtarve , si rezultat i Pandemisë COVID -19, kërkoj që të mirret parasysh të gjitha këto vështërsi të krijuara për kompanit Transportit me autobus të udhëtarve, dhe miratimin e këtij propozim – Vendimi.